



KOMUNIKATË PËR MEDIA Kampanjë vetëdijësuese për kujdes gjatë vozitjes

30 korrik 2018, Gjakovë

Sot është realizuar kampanja vetëdijësuese kundër përdorimit të telefonave gjatë vozitjes e cila shërben si një thirrje e radhës për ngasësit e automjeteve që të kenë kujdes të shtuar gjatë vozitjes.

EC Ma Ndryshe ka organizuar Shkollën e Aktivizmit me nxënës të shkollave të mesme nga ku edhe ka dalur si shqetësim përdorimi i telefonave nga ngasësit gjatë vozitjes, duke cënuar sigurinë në trafik. Si rrjedhojë e kësaj ka dalur edhe idea për realizimin e kësaj kampanje vetëdijësuese nga nxënësja Kleita Koci, për kujdes të shtuar gjatë vozitjes. Ky aktivitet është organizuar në bashkëpunim me KVRL- GJK dhe qytetarët e qytetit të Gjakovës, me ç'rast është bërë shpërndarja e fletushkave që përmbajnë mesazhe sensibilizuese dhe statistika të aksidenteve që kanë ndodhur që nga viti 2017 në rajonin e Gjakovës dhe në tërë Kosovën.

Bazuar në statistikat e marra nga Policia e Kosovës vërehet një rënie në numrin e aksidenteve por prapë numri i atyre me fatalitet në trafik vazhdon të jetë shqetësues. Në rajonin e Gjakovës gjatë vitin 2017 kanë ndodhur gjithsej 1056 aksidente, 11 prej tyre kanë përfunduar me fatalitet me 14 persona të vdekur ndërsa në periudhën janar-qershor 2018 kanë ndodhur 372 aksidente, 4 prej tyre fatale me 4 persona të vdekur. Sa i përket territorit të Kosovës gjatë vitit 2017 kanë ndodhur gjithsej 17695 aksidente ku 122 prej tyre kanë qenë fatale dhe kanë rezultuar me 137 persona të vdekur. Gjatë periudhës janar-qershor të këtij viti kanë ndodhur gjithsej 7003 aksidente ku 41 prej tyre kanë përfunduar me fatalitet dhe me 52 persona të vdekur.

Kjo kampanjë shërben si thirrje për vozitësit që të shtojnë kujdesin në trafik duke mos përdorur telefonat, duke repektuar rregullat e komunikacionit, të vendosin rripin e sigurisë dhe ta përshtasin shpejtësinë sipas shenjave të urdhërave të prera. Në krahasim me vitin e kaluar vërehet një rënie në numrin e aksidenteve të trafikut ndërsa rritje në numrin e tiketave të shqiptuara andaj edhe ky aktivitet shërben edhe si një thirrje ndaj institucioneve që të vazhdojnë të ndërmarrin hapa konkret në shtimin e sigurisë në komunikacion.

Ky grant është financuar nga projekti 'Përkrahja e Luksemburgut për shoqërinë civile në Kosovë', financuar nga Qeveria e Dukatit të Madh të Luksemburgut dhe menaxhuar nga Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF). Përmbajtja dhe rekomandimet e paraqitura nuk

përfaqësojnë qëndrimin zyrtar të Qeverisë së Dukatit të Madh të Luksemburgut dhe Fondacionit Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF).

OJQ EC Ma Ndryshe

Rr. Saraçët, Nr. 5 - Prizren

Bulevardi Nënë Tereza, H 30 B1 Nr. 5, Prishtinë

www.ecmandryshe.org & info@ecmandryshe.org

+381 38 224 967 & +381 29 222 771

Ky dokument është hartuar për qëllime të projektit 'Përkrahja e Luksemburgut për shoqërinë civile në Kosovë', financuar nga Dukati i Madh i Luksemburgut dhe menaxhuar nga Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF).